

20110170381

**LIGJ
PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTESIMIN E
LIGJIT PËR VEPRIMTARI TURISITKE**

Neni 1

Në Ligjin për veprimtari turistike ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numer 62/2004, 89/2008 dhe 12/2009), pas nenit 19 shtohet neni i ri 19-a, si vijon:

"Neni 19-a

Kryeresit e veprimtarisë turistike gjatë organizimit të udhetimeve turistike, në programet e udhëtimit që përfshijnë aktivitete rekreative sportive, aventurore dhe ekstreme (skijim, zhytje, lundrim, kalerim, vozitje në vende të larta-malore, lundrim me trap, rafting, hulumtime shpellash, vozitje të kanuas dhe automjete tjera të ujit, parashutizem, lundrim me vela, paraglajder, kercim me litar dhe ngjashem, përveç angazhimit të udhërrefyeshve turistike, duhet të angazhojnë edhe persona të aftësuar profesionalist për aktivitete të atilla (trajnuer, instruktore, udhërrefyesh etj)."

Neni 2

Në nenin 21 paragrafi 1 pika 2 ndryshohet si vijon:

"t'i kthehet shuma e plote të cilën e ka paguar sipas marreveshjes, në afat që nuk mund të jete më i gjatë se 15 dite nga dita e prishjes së marreveshjes, përveç nëse prishja është rezultat e forës madhore. Si forë madhore nënkuptohet tere ajo që është rregulluar me Ligjin për marrëdhënie të obligueshme."

Neni 3

Në nenin 25 paragrafi 2 ndryshohet si vijon:

"Licenca mund të jete: licence "A" dhe licence "B".

Neni 4

Në nenin 26 paragrafi 2 pika 1 pas fjalës "regjister", shtohen fjalet: "dhe Dokument për regjistrimin e veprimtarisë (formulari DRD)".

Në pikën 3 pikepresja zëvendësohet me lidhezen "dhe".

Në pikën 4 pikepresja zëvendësohet me pike.

Pika 5 shlyhet.

Neni 5

Në nenin 27 paragrafi 3 ndryshohet si vijon:

"Periudha e vlefshmerisë së licences është e pakufizuar."

Neni 6

Në nenin 30 paragrafi 1 ndryshohet si vijon:

"Licenca shfuqizohet:

- 1) në baze të kërkesës së bartesit të licences për shlyerje nga regjistri i agjencive turistike;
- 2) në baze të aktvendimit për heqjen e licences dhe
- 3) nëse agjencia turistike në periudhën e vlefshmerisë së licences pushon t'i plotësojë kushtet për kryerjen e veprimtarisë turistike, përkatësisht kushtet e përcaktuara për marrjen e licences përkatëse të parapara në nenet 31 dhe 32 të këtij ligji."

Neni 7

Pas nenit 30 shtohet neni i ri 30-a, si vijon:

"Neni 30-a

Ministri i cili udheheq me organin e administrates shteterore kompetent për punet nga sfera e turizmit, mund ta heqe licencen nese:

1) organizatori i udhetimit në periudhen e vlefshmerise së licences pushon t'i plotesoje së paku dy nga kushtet e parapara për marrjen e licences, në pajtim me nenin 31 të ketij ligji;

2) organizatorit të udhetimit në periudhen e vlefshmerise së licences i shqiptohet më shume se dy here mase për kundervajtje dhe administrative, për mosplotesimin e detyrimeve nga nenet 15 paragrafi 1 pikat 5, 7, 10, 14 dhe 15 dhe 36 paragrafi 3 pika 11, 14 dhe 15 të ketij ligji dhe

3) Agjencia turistike - ndermjetesues me licence "B" shet aranzhmane të veta turistike."

Neni 8

Në nenin 31 paragrafi 1 në fjaline hyrese shtohen fjalet: "- organizator i udhetimit".

Neni 3 ndryshohet si vijon:

"të kete së paku kater persona të punesuar, prej të cileve së paku njeri me arsim të larte dhe dy me deshmi se e njohin një gjuhe boterore dhe"

Neni 9

Neni 32 ndryshohet si vijon:

"Për marrjen e licences "B" Agjencia turistike - ndermjetesues në shitjen e udhetimeve turistike, detyrimisht duhet t'i plotesoje keto kushte:

1) të kete së paku një person të punesuar, me deshmi se e njeh një gjuhe të huaj dhe

2) të kete të nenshkruar marreveshje për bashkepunim me agjenci turistike - organizator i udhetimit, me licence "A"."

Neni 10

Neni 33 shlyhet.

Neni 11

Në nenin 33-b paragrafi 4 ndryshohet si vijon:

"Lartesine e harxhimeve nga paragrafi (1) i ketij neni, varesisht nga harxhimet faktike për dhenien e provimit profesional, e percakton institucioni i larte arsimor për turizem dhe hotelieri."

Neni 12

Në nenin 37 paragrafi 2 pas fjaleve: "aktivitete në" shtohen fjalet: "vend dhe".

Paragrafi 3 shlyhet.

Neni 13

Neni 38 shlyhet.

Neni 14

Ne nenin 42 paragrafi 4 ndryshohet si vijon:

"Lartesine e harxhimeve nga paragrafi 1 i ketij neni, varesisht nga harxhimet faktike për dhenien e provimit profesional, e percakton institucioni i larte arsimor për turizem dhe hotelieri."

Neni 15

Në nenin 45-b paragrafi 4 ndryshohet si vijon:

"Lartesine e harxhimeve nga paragrafi 1 i ketij neni, varesisht nga harxhimet faktike për dhenien e provimit profesional, e percakton institucioni i larte arsimor për turizem dhe hotelieri."

Neni 16

Ne nenin 57 paragrafi 2 ndryshohet si vijon:

"Për zhvillim më të shpejte të turizmit dhe formimit të cmimeve më konkurruese të aranzhmanit turistik për turiste të huaj, ministri kompetent për punet nga sfera e turizmit do ta percaktoje menyren, llojin dhe lartesine e subvencioneve."

Neni 17

Neni 61 ndryshohet si vijon:

"Nese gjate kryerjes së mbikeqyrjes inspektuese, inspektori shteteror i tregut, perkatesisht inspektori i autorizuar i komunes dhe inspektori i autorizuar i qytetit të Shkupit konstaton se për here të pare eshte bere parregullsi nga nenet 67 paragrafi 1 pika 3 dhe 68 paragrafi 1 pika 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7 dhe 8 të ketij ligji, inspektori shteteror i tregut, perkatesisht inspektori i autorizuar eshte i detyruar që të perpiloje procesverbal në të cilin do ta konfirmoje parregullsine e kryer me sugjerim për evitim të parregullsise së kryer në afat prej tete ditesh dhe dorezimin e njekohshem të fteses për realizimin e edukimit të personit, ose subjektit ku eshte konstatuar parregullsia gjate kryerjes së mbikeqyrjes inspektuese.

Formen dhe permbajtjen e fteses për edukim, si dhe menyren e realizimit të edukimit e percakton ministri i cili udheheq me organin e administrates shteterore për kryerjen e puneve nga sfera e ekonomise, perkatesisht kryetari i komunes dhe kryetari i Qytetit të Shkupit.

Edukimin e organizon dhe realizon Inspektorati Shteteror i Tregut, perkatesisht organi i administrates shteterore i cili e ka kryer mbikeqyrjen inspektuese në afat jo më të gjate se tete dite, nga dita e realizimit të mbikeqyrjes inspektuese.

Edukimi mund të realizohet për më shume parregullsi të konstatuara të njejta ose të ngjashme, për një ose me shume subjekte.

Nese në terminin e caktuar, personi ose subjekti për të cilin zbatohet edukimi nuk paraqitet ne edukim, do të konsiderohet se edukimi eshte zbatuar.

Nese personi ose subjekti për të cilin zbatohet edukimi, paraqitet në edukimin e caktuar dhe të njejtin e kryen, do të konsiderohet se eshte edukuar për parregullsine e konstatuar.

Nese inspektori shteteror i tregut, perkatesisht inspektori i autorizuar gjate zbatimit të mbikeqyrjes kontrolluese percakton se jane menjanuar parregullsite e konstatuara nga paragrafi 1 i ketij neni, miraton konkluzion me të cilen e nderprene proceduren e mbikeqyrjes inspektuese.

Nese inspektori shteteror i tregut, perkatesisht inspektori i autorizuar gjate zbatimit të mbikeqyrjes kontrolluese konstaton se nuk jane menjanuar parregullsite e konstatuara nga paragrafi 1 i ketij neni, parashtron kerkese për ngritjen e procedures për kundervajtje para Komisionit për Kundervajtje.

Inspektori shteteror i tregut, perkatesisht organi i administrates shteterore i cili e ka kryer mbikeqyrjen inspektuese dhe i cili e ka organizuar dhe e ka zbatuar edukimin, mban evidence për edukimin e zbatuar në menyre të percaktuar nga ministri i cili udheheq me organin e administrates shteterore, që eshte kompetent për kryerjen e puneve nga sfera e ekonomise, perkatesisht kryetari i komunes dhe kryetari i qytetit të Shkupit.

Neni 18

Neni 62 shlyhet.

Neni 19

Neni 65 ndryshohet si vijon:

"Nese inspektori shteteror i tregut, perkatesisht inspektori i autorizuar gjate kryerjes së mbikeqyrjes inspektuese konstaton se kryeresi i veprimtarise turistike:

- 1) kryen aktivitete që jane në kundërshtim me dispozitat nga neni 37 i ketij ligji;
 - 2) kryen veprimtari u regjistruar në regjistrin tregtar (neni 3 paragrafi 1);
 - 3) nuk lidh marreveshje me shfrytëzuesin e shërbimit në të cilin qartësisht do të përcaktohen kushtet dhe menyra e dhenies së shërbimeve (neni 15 paragrafi 1 pika 5);
 - 4) nuk ka licence për kryerjen e veprimtarise turistike (neni 25 paragrafi 1);
 - 5) poseduesi i licences "A" gjate kryerjes të veprimtarise së vet nuk i përmbush kushtet nga neni 31 i ketij ligji;
 - 6) poseduesi i licences "B" gjate kryerjes të veprimtarise së vet nuk i përmbush kushtet nga neni 32 i ketij ligji dhe
 - 7) nuk është i regjistruar për kryerjen e veprimtarise turistike (nenet 3 paragrafi 2 dhe 51 paragrafi 2);
- do të miratoje aktvendim për ndalimin e perkohshëm në kohezgjatje prej 30 ditësh.

Kunder aktvendimit nga ky nen mundet në afat prej tete ditësh, nga dita e pranimit të aktvendimit, të parashtrohet ankese te ministri i Ekonomise.

Ankesa e parashtruar kunder aktvendimit nga ky nen, nuk e prolongon zbatimin e aktvendimit."

Neni 20

Neni 66 shlyhet.

Neni 21

Në nenin 66-a paragrafi 1 ndryshohet si vijon:

"Për kundërvajtjet e përcaktuara në nenin 67, 68 dhe 70 të ketij ligji, procedure kundërvajtëse mban dhe sanksion kundërvajtës shqipton Inspektorati Shteteror i Tregut (në tekstin e mëtejshëm: Organi Kundërvajtës)."

Neni 22

Neni 67 ndryshohet si vijon:

"Gjore në shume prej 400 eurosh në kundërvlere me denare do t'i shqiptohet aty për aty për kundërvajtje të personit fizik, nese:

- 1) nuk është i regjistruar për kryerjen e veprimtarise turistike (nenet 3 paragrafi 2 dhe 51 paragrafi 2);
- 2) nuk organizon udhëtim turistik për anëtarët e vet dhe anëtarët e familjes së tij më të ngushtë nepermjet agjencive turistike, publikisht i shpall dhe i reklamon udhëtimet turistike (neni 6 paragrafi 1);
- 3) kryen veprimtari të udhërfyesit turistik, personi i cili është punëtor profesional që e kryen veprimtarine si udhërfyes në vendin e vet të punës të personat juridike në objektin afarist në të cilin punon (muze, galeri, park nacional, etj.), punëtorin profesional i agjencise turistike e cila shoqeron grup turistesh në vend, udhërfyesi në mal dhe shpelle, udhërfyesi në gjueti dhe peshkatari, si dhe udhërfyesi apo shoqeruesi në ekskursionë dhe shetitje (neni 39 paragrafi 2) dhe
- 4) kryen veprimtari turistik si udhërfyes apo shoqerues turistik pa e dhene provimin adekuat profesional (nenet 40 paragrafi 2 dhe 45-a paragrafi 1).

Inspektori i autorizuar i komunes dhe inspektori i autorizuar i qytetit të Shkupit, për kundërvajtjet nga paragrafi 1 i ketij neni, është i detyruar që kryeresit të kundërvajtjes t'i dorezoje ftese për pagimin e gjores në afat prej tete ditësh, nga dita e dorezimit të fteses.

Nese kryeresi vullnetarisht nuk e paguan ftesen nga paragrafi 1 i ketij neni, inspektori i autorizuar i komunes dhe inspektori i autorizuar i qytetit të Shkupit, për kundervajtjet parashtron kerkese për ngritjen e procedures kundervajtese para Komisionit për Kundervajtje."

Neni 23

Neni 68 ndryshohet si vijon:

Gjobe në shume prej 1 000 eurosh në kundervlere me denare do t'i shqiptohet aty për aty për kundervajtje personit juridik, nese:

1) nuk e njofton me formular të posacem DPI edhe kryetarin e komunes, kurse në qytetin e Shkupit, kryetari i komunes së rajonit të qytetit të Shkupit, sipas vendit të selise së objektit, perkatesisht sipas vendit ku jepen sherbimet turistike, së paku tete dite para fillimit të kryerjes së veprimtarise (neni 9 paragrafi 1);

2) në hyrjen e lokalit afarist nuk e paraqet firmen (neni 15 paragrafi 1 pika 1);

3) shenjen "agjenci turistike", "agjencia udhetimi" dhe shprehjet e zakonshme siç jane "Tours" dhe "Travel" dhe ngjashem, në firme nuk i shfrytezojne agjencite turistike (neni 15 paragrafi 1 pika 2);

4) për shitjen e biletave të avioneve, agjencia turistike nuk ka të punesuar person me certifikaten IATA (neni 15 paragrafi 1 pika 11);

5) në vend të dukshem në agjencine turistike nuk e paraqet licencen (neni 15 paragrafi 1 pika 12);

6) nuk i paraqet cmimet e aranzhmaneve turistike dhe sherbimeve të vecanta (neni 15 paragrafi 1 pika 13);

7) në vendin e dukshem në hyrjen e objektit turistik nuk e paraqet llojin e kartelave pagesore të cilat mund të shfrytezohen (neni 15 paragrafi 1 pika 16);

8) gjate organizimit të udhetimeve turistike, në programet e udhetimit të cilat perfshijne aktivitete sportive - rekreative, aventurore dhe ekstreme, pervec angazhimit të udherrefyesve turistike, nuk angazhon edhe persona të afte profesionalisht për aktivitete të atilla (neni 19-a);

9) nuk e paraqet orarin e punes në hyrjen e objektit dhe në vendin e dukshem në objekt dhe nuk i permbahet orari të caktuar të punes (neni 56);

10) nuk i permbush kushtet e percaktuara minimale - teknike (neni 8 paragrafi 1);

11) lokali afarist shfrytezohe edhe për dedikim tjetet (banim dhe prodhim), në kundershtim me dispozitat e nenit 10 paragrafi 2 të ketij ligji;

12) me kerkese të shfrytezuesit të sherbimeve nuk i jep informata në cilen cilesi vepron dhe sa jane autorizimet e tij, nese perfaqeson agjenci tjetet turistike (neni 15 paragrafi 1 pika 4);

13) në materialet e promovuara të shtypit, si edhe në të gjitha dokumentet e punes dukshem nuk paraqitet firma dhe selia e agjencise turistike (neni 15 paragrafi 1 pika 6);

14) nuk i permbahet gjate shitjes edhe realizimi, marreveshjes dhe programit të aranzhmanit turistik (neni 15 paragrafi 1);

15) marreveshja nuk i permban elementet e parapara në nenin 16;

16) vauceri turistik nuk i permban elementet e parapare në nenin 17 paragrafi 3 nga të ketij ligji dhe

17) nuk e paraqet ndryshimin e permbajtjes së licences (29).

Gjobe me shume prej 200 eurosh në kundervlere me denare, do t'i shqiptohet aty për aty edhe personit pergjegjes në personin juridik, për veprimet nga neni 1 i ketij neni.

Gjobe më shume prej 300 eurosh në kundervlere me denare, do t'i shqiptohet aty për aty tregtarit individual, për veprimet nga paragrafi 1 i ketij neni.

Inspektori shteteror i tregut për kundervajtje nga paragrafi 1 i ketij neni eshte i detyruar që kryeresit të kundervajtjes t'i dorezoje ftese për pagimin e gjobes në afat prej tete ditesh, nga dita e dorezimit te fteses.

Nese kryeresi vullnetarisht nuk e paguan gjoben nga ky nen, inspektori shteteror i tregut parashtron kerkese për ngritjen e procedures për kundervajtje para Komisioni për Kundervajtje."

Neni 24

Neni 70 ndryshohet si vijon:

Gjobe në shume prej 1200 eurosh në kundervlere me denare, do të shqiptohet për kundervajtje personit juridik, nese:

1) dega ei agjencise turistike kryen aktivitete në kundershtrim me licencen që e posedojne agjencite turistike (neni 11 paragrafi 2);

2) lidh marreveshje me ndermarrje të komunikacionit mjetet transportuese të të cilave, nuk i plotesojne kushtet e percaktuar me dispoziten nga sfera e komunikacionit rrugor publik (neni 15 pika 7);

3) lidh marreveshje dhe ndermerr aktivitete tjera afariste me subjekte juridike afariste të cilat nuk posedojne licence dhe kategorizim të objektit (neni 15 paragrafi 1 pika 8);

4) nuk e ruan si sekret afarist gjithcka që di për shfrytezuesit e sherbimeve dhe pa lejen e tij, perpos në kushte të percaktuara ligjore, e jep adresen e shfrytezuesit të sherbimit, vendin dhe kohen e udhetimit, qendrimin, cmimin e paguar, si dhe emrin e bashkudhetarit të tij (neni 15 paragrafi 1 pika 9);

5) nuk i permbahet kushteve të percaktuara në marreveshje të cilat i vendos me shfrytezuesit e sherbimeve dhe personat e trete si dhenes të sherbimeve (neni 15 paragrafi 1 pika 10);

6) për çdo sherbim ose aranzhman të shitur nuk i leshon fature nga arka fiskale, si dhe vaucer turistik për vendosje dhe sherbime tjera shfrytezuesit të sherbimeve (neni 15 paragrafi 1 pika 14);

7) kryeresit e veprimtarise turistike gjate organizimit të udhetimeve turistike në vende të huaja me autobus jane të obliguar të sigurojne që mjeti transportues t'i plotesoje kushtet në pajtim me dispozitat nga sfera e komunikacionit publik rrugor dhe të kete aparat për klime, frigorifer, WC dhe mikrofon për shpallje (neni 19);

8) kryen rritje e cmimit të percaktuar në marreveshje 20 dite para dites së kontraktuar për fillimin e shfrytezimit të sherbimeve turistike (neni 20);

9) nuk ia kthen shumen e plote të cilen e ka paguar sipas marreveshjes, pervec rasteve që parashihen në nenet 21 paragrafi 1 pika 2 të ketij ligji;

10) nuk vepron sipas nenit 21 paragrafet 2 dhe 3 të ketij ligji;

11) gjate realizimit të aranzhmanit turistik ose qendrimit, ose qendrimit në vende të huaja, personave të mitur nuk u mundeson informate për vendosjen e kontaktit të drejtperdrejte me femijen dhe personin pergjegjes për dhenien e sherbimeve femijeve në vendin e udhetimit dhe qendrimit (23 paragrafi 2) dhe

12) gjate realizimit të aranzhmanit turistik, ose udhetim, ose qendrimit në vende të huaja nuk ka deshmi se posedon licence (kopje e vertetuar nga noteri), marreveshje me objektet e vendosjes në vende të huaja dhe deshmi për pagesen e kryer për sherbime të vendosjes dhe sherbime tjera permes institucionit perkates bankar (neni 24).

Gjobe në shume prej 300 eurosh në kundervlere me denare do t'i shqiptohet personit pergjegjes në personin juridik, për veprimet nga neni 1 i ketij neni.

Gjobe me shume prej 500 eurosh në kundervlere me denare do t'i shqiptohet tregtarit individual, për veprimet nga paragrafi 1 i ketij neni. Për kundervajtjet e percaktuara në kete nen, Inspektorati Shteteror i Tregut eshte i obliguar që t'i propozoje kryeresit të kundervajtjes procedure për barazim, para se të parashtroje kerkese për procedure për kundervajtje në Komisionin për Kundervajtje."

Neni 25

Neni 71 ndryshohet si vijon:

"Gjobe në shume prej 2 000 deri në 4 000 euro në kundervlere me denare, do t'i shqiptohet për kundervajtje personit juridik, nese:

1) nuk organizon udhetim turistik për anetaret e vet dhe anetaret e familjes se tij më të ngushte përmes agjencive turistike, publikisht i shpall dhe i reklamon udhëtimet turistike (neni 6 paragrafi 1);

2) kryen aktivitete që janë në kundërshtim me dispozitat nga neni 37 të këtij ligji;

3) kryen veprimtari pa u regjistruar në regjistrin tregtar (neni 3 paragrafi 1);

4) nuk lidh marrëveshje me shfrytëzuesin e shërbimit në të cilën qartësisht do të përcaktohen kushtet dhe menyra e dhenies së shërbimeve (neni 15 paragrafi 1 pika 5);

5) nuk ka licence për kryerjen e veprimtarisë turistike (neni 25 paragrafi 1);

6) pronari i licences "A" gjatë kryerjes së veprimtarisë së vet nuk i përmbush kushtet nga neni 31 i këtij ligji dhe

7) pronari i licences "B" gjatë kryerjes së veprimtarisë së vet nuk i përmbush kushtet nga neni 32 i këtij ligji.

Gjobe në shume prej 500 deri në 1 000 euro në kundervlere me denare, do t'i shqiptohet personit përgjegjës në personin juridik, për veprimet nga paragrafi 1 i këtij neni.

Gjobe në shume prej 700 deri në 1 000 euro në kundervlere të denare, do t'i shqiptohet tregtarit individual, për veprimet nga paragrafi 1 i këtij neni.

Për kundervajtjet e përcaktuara në këte nen, inspektor i shtetëror i tregut është i obliguar që të parashtrijë kërkesë për procedurë për kundervajtje në gjykatën kompetente."

Neni 26

Neni 72 shlyhet.

Neni 27

Inspektorati Shtetëror i Tregut procedurën e barazimit dhe procedurën për kundervajtje, i ndeheq në pajtim me Ligjin për Inspektoratin Shtetëror të Tregut dhe Ligjin për kundervajtje.

Neni 28

Autorizohet Komisioni Juridik Ligjvënës i Kuvendit të Republikës së Maqedonisë, që të përcaktojë tekst të spastruar të Ligjit për veprimtari turistike.

Neni 29

Akti nenligjor i parapare me këte ligj do të miratohet në afat prej 15 ditësh, nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 30

Kryerësit e veprimtarisë turistike detyrohen që ta harmonizojnë punën e tyre, sipas neneve 25, 31 paragrafi 1 pika 3 dhe 32 të Ligjit për veprimtari turistike ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numer 62/2004, 89/2008 dhe 12/2009), në afat prej gjashtë muajsh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 31

Ky ligj hyn në fuqi ditën e tete nga dita e botimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë".